

REPORTAZH



BULQIZA, DRITË NË FUNDIN E TUNELIT...

NGA NDUE DEDAJ

Faqe 4-5

ESSE



TRI RRËFIME TË PARA TRIDHJETË VJETËSH

NGA VETON SURROI

Faqe 9

KULTURE



BUJAR KAPEXHIU DHE FOLK ALB "HAZIS NDREU"

HALIL RAMA

Faqe 7

Krijohet Këshilli Politik me përfaqësues të pozitës dhe opozites

STARTON REFORMA ZGJEDHORE



NGA EDMOND ISAKU

Ngjarja më e rëndësishme politike e ditëve të fundit është krijimi i Këshillit Politik për reformën zgjedhore, me përfaqësues të maxhorancës dhe opozitës jashtëparlamentare. Ky hap i radhës erdhi pas marrëveshjes së arritur mes maxhorancës dhe opozitës, të cilat u ulën në një tryezë për reformën zgjedhore, si një nga kushtet e Bundestagut për çeljen e negociatave. PD do të përfaqësohet nga Oerd Bylykbashi, ndërsa LSI nga Petrit Vasili, Mesila Doda nga PDIU, Fatmir Mediu nga Partia Republikane dhe Vangjel Dule i PBDNJ-së. Ndërkohë nga maxhoranca do të marrin pjesë bashkëdrejtuesit e Komisionit Parlamentar të Reformës Zgjedhore Damian Gjikonuri dhe Rudina Hajdari. Po ashtu pjesë e tryezës do të jetë dhe anëtari i grupit parlamentar të PS, Ervin Bushati, ndërsa nga grupi parlamentar demokrat, Myslim Murri si dhe përfaqësues i grupit të pavarur parlamentar Nimet Musai. Afati i përfundimit të refrmës zgjedhore parashikohet brenda dy muajve të ardhshme deri më 15 mars 2020. Shqipëria do të ketë një ligj të ri zgjedhor plotësisht konsensual dhe si-

Faqe 2



- *“Reforma do të mbështesë procese zgjedhore të efektshme dhe të besueshme dhe do të forcojë demokracinë shqiptare. Ne shpresojmë që palët të vijojnë të ecin përpara me këtë frymë aktuale bashkëpunimi, për t’u siguruar që zgjedhet në Shqipëri të jenë të lira nga mashtrimi, ndërhyrja dhe korrupsioni” - thuhet në deklaratën e ambasadës së SHBA-ve në Shqipëri*

AKTUALITET

Ismail Keta nuk është vetëm një kampion bote, por edhe një njeri shpirtmadh, me ndjesi të larta humane



**Kampioni i Botës
Ismail Keta sjell
pajisje për
klinikën
stomatologjike të
spitalit Bulqizë**

Faqe 6

REAGIMI

Faqe 3

Bundestagu përshëndet nisjen e procesit për reformën zgjedhore:

1 nga 9 kushtet për hapjen e negociatave



SPECIALE

Faqe 8

Problemet e mëdha të Evropës në vitin 2020



NDERIM

Faqe 12

Major Klodian Tanushi i jepet titulli “Nderi i Qarkut Dibër” pas vdekjes



LETRAT

Faqe 11

Poemë e dhimbjes, kënduar vajshëm

POEZI NGA DHURATA KOLA KALOSHI

Krijohet Këshilli Politik me përfaqësues të pozitës dhe opozitës

REFORMA ZGJEDHORE ME KONSENSUSIN E OPOZITËS DERI MË 15 MARS

• “Reforma do të mbështesë procese zgjedhore të efektshme dhe të besueshme dhe do të forcojë demokracinë shqiptare. Ne shpresojmë që palët të vijojnë të ecin përpara me këtë frymë aktuale bashkëpunimi, për t’u siguruar që zgjedhet në Shqipëri të jenë të lira nga mashtrimi, ndërhyrja dhe korrupsioni” - thuhet në deklaratën e ambasadës së SHBA-ve në Shqipëri

Tryeza e mesdites se 14 janarit 2019 ne kuader te Reformes Zgjedhore, që mbledhi bashke edhe dy të mandatuarit e opozites, ka prodhuar dokumentin e parë, ndërkohë që opozita ka realizuar atë që synonte: “Partia Socialiste ka rënë dakord që diskutimet kryesore për reformën t’i bëjë një grup pune me përbërje të barabartë prej 4 anëtarësh. Ata janë bashkëkryetarët e Komisionit për Reformën Zgjedhore, Damian Gjiknuri, Rudina Hajdari, si dhe përfaqësuesit e koalicionit opozitar, Oerd Bylykbashi, Petrit Vasili”.

Ne dokumentin qe publikojmë më poshtë , palët kanë rënë dakord të formojnë Këshillin Politik me përfaqësues të opozites, drejtuesve të komisionit të



Reformës Zgjedhore dhe përfaqësuesve të grupeve parlamentare në Kuvend.

Pra komisioni i Reformës Zgjedhore nuk do të jetë vendi ku do të arrihet konsensusi mes qeverisë dhe opozitës për reformën zgjedhore. Këtë e për-

cakton “Kuai i Bashkëpunimit për Reformën Zgjedhore”, i dakordësuar mes qeverisë dhe opozitës.

Në dokumentin final bie në sy fakti se marrëveshja është firmosur nga Damian Gjiknuri, Oerd Bylykbashi, Petrit Vasili, por jo nga Rudina Hajdari.

SHBA, BE dhe OSBE përshëndesin Marrëveshjen




Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri përshëndeti palët që ranë dakord të punojnë së bashku për reformën zgjedhore, një hap i rëndësishëm për të trajtuar plotësisht rekomandimet e ODIHR-it.

“Reforma do të mbështesë procese zgjedhore të efektshme dhe të besueshme dhe do të forcojë demokracinë shqiptare. Ne shpresojmë që palët të vijojnë të ecin përpara me këtë frymë aktuale bashkëpunimi, për t’u siguruar që zgjedhet në Shqipëri të jenë të lira nga mashtrimi, ndërhyrja dhe korrupsioni” - thuhet në deklaratën e ambasadës së SHBA-ve në Shqipëri.

Marrëveshja mes forcave kryesore politike u përshëndet edhe nga Bashkimi Evropian. Kreu i misionit të BE-së në Tiranë, Luigi Soreca, tha se marrëveshja e sotme politike është një arritje e rëndësishme për rikthimin e stabilitetit politik në Shqipëri dhe për rrugën drejt integritetit në BE.

“Ne mirëpresim marrëveshjen e sotme ndërpartiake mbi rrugën përpara për një reformë gjithëpërfshirëse zgjedhore, në përputhje me rekomandimet e OSBE-ODIHR. Ne besojmë se të gjitha partitë do të vazhdojnë të punojnë së bashku për të përfunduar një reformë zgjedhore në kohë, që do të miratohet nga Parlamenti, në të mirë të qytetarëve shqiptarë dhe të së ardhmes së tyre evropiane” - tha në rrjetet sociale ambasadori Soreca. Prezenca e OSBE-së në Shqipëri mirëpriti marrëveshjen e sotme politike për reformën zgjedhore. “E shohim këtë marrëveshje si një hap të parë të rëndë-

sishëm drejt një reforme të plotë e në kohën e duhur, që do të trajtojë të gjitha rekomandimet e OSBE/ODIHR-it, në dobi të të gjithë qytetarëve shqiptarë” - thuhet në deklaratën e OSBE-së, e cila shtoi se mbetet e gatshme të vijojë të ndihmojë në procesin e reformës zgjedhore. Prezenca e OSBE-së në Shqipëri mirëpriti marrëveshjen e sotme politike për reformën zgjedhore. “E shohim këtë marrëveshje si një hap të parë të rëndësishëm drejt një reforme të plotë e në kohën e duhur, që do të trajtojë të gjitha rekomandimet e OSBE/ODIHR-it, në dobi të të gjithë qytetarëve shqiptarë” - thuhet në deklaratën e OSBE-së, e cila theksoi se mbetet e gatshme të vijojë ndihmën në procesin e reformës zgjedhore.



STARTON REFORMA ZGJEDHORE

Vijon nga faqja 1

pas standardeve më të mira ndërkombëtare. Krijimi i Këshillit Politik, tregoi se periudha 1 vjeçare e daljes së opozitës zyrtare nga Parlamenti, ka prodhuar tashmë një realitet të ri politik. Megjithatë jemi në qëndrimet paraprake të palëve, duket se nuk do të kemi një ndryshim të sistemit elektoral. Megjithatë komisioni duket i preokupuar që çdo opsion ta diskutojë në tryezë. Kjo momentalisht është një arritje e re politike drejt reformave që Shqipëria po ndërmerr për t’ anëtarësuar në BE. Kishte muaj që kërkohej një dialog i hapur dhe gjithëpërfshirës i dakorduar mes të gjitha forcave politike. Reforma zgjedhore duhet të jetë plotësisht në përputhje me rekomandimet e OSBE / ODIHR-it. Këtë ka kërkuar dhe Bundestag-u gjerman në rezolutën e tij të 26 shtatorit 2019. E rëndësishme është që palët të kenë vulnetin politik dhe të punojnë për një marrëveshje që t’i rezistojë kohës dhe situatës kaotike në kushtet e krizës besimit që ekziston midis faktorëve politikë elektoralë. Deri tani mund të themi që është zgjidhur vetëm çështja procedurale. Fryt i këtij komisioni do të jetë përmbajtja e marrëveshjes që do të finalizohet në mars 2020. Në kushtet kur opozita duket se kish hyrë në një rrugë pa krye, tani kjo zgjidhje duket më shumë si një fitore ose zgjidhje ngërçi për opozitën shqiptare. Ngritja e komisionit politik për reformën duke anashkaluar parlamentin tregon për realizimin dhe synimin që opozita i kish vënë vetes duke e quajtur parlamentin ilegjitim. Basha dhe opozita ia dolën të deligitimojnë parlamentin duke e kthyer mos i dhënë fuqi ndryshues draftit të dakortësuar në komision. Opozita pagoi kosto të lartë me daljen nga parlamenti por tani duhet thënë së ia doli mbanë synimit të saj opozitar për ta çuar vendin drejt një reformimi elektoral dhe drejt zgjedhjeve të parakohëshme. Arritja e kësaj marrëveshje që i hap rrugën dialogut të munguar, edhe për shumë çështje dhe zgjidhje të tjera. SHBA, BE, OSBE dhe Britania e Madhe e kanë duartrokur këtë hap, duke inkurajuar palët për të shkuar drejt një reforme që do të sjellë më pas zgjedhje të lira në standarte demokratike.

Bundestagu përshëndet nisjen e procesit për reformën zgjedhore: 1 nga 9 kushtet për hapjen e negociatave

Nënkryetari i grupit parlamentar CDU/CSU në Bundestagun Gjerman, Johann David Wadephul, e ka përshëndetur nismën e re të pozitës dhe opozitës së bashkuar në Shqipëri për reformimin e ligjit zgjedhor

Në një deklaratë ekskluzive për Dw shqip nënkryetari i grupit më të madh parlamentar në parlamentin gjerman CDU/CSU, Johann David Wadephul e ka përshëndetur arritjen e marrëveshjes mes pozitës dhe opozitës së bashkuar në Shqipëri për hartimin e ligjit të ri zgjedhor: “Grupi parlamentar i CDU / CSU në parlamentin gjerman e përshëndet marrëveshjen e djeshme midis qeverisë dhe opozitës. Dialogu i hapur dhe gjithëpërfshirës i dakorduar tani mes të gjitha forcave politike është një hap i rëndësishëm për hartimin e reformës së re zgjedhore, e cila duhet të jetë plotësisht në përputhje me rekomandimet e OSBE / ODIHR-it, siç e ka kërkuar dhe Bundestag-u gjerman në rezolutën e tij të 26 shtatorit 2019. Ne i inkurajojmë të gjitha palët që në këtë frymë mbipartiake të përfundojnë me sukses punën ende të vështirë për reformimin e ligjit zgjedhor”, thuhet në deklaratën e deputeti i kristiandemokrat, i cili është njëkohësisht edhe kryetar i grupit të punës për Ballkanin Perëndimor të



kësaj partie në Bundestag.

Vënia në vijë e reformës zgjedhore, ishte, krahas plotësimi të stafit të nevojshëm për funksionimin e Gjykatës Kushtetuese, një nga dy kushtet e vëna nga Bundestagu gjerman për fillimin e procesit të çeljes së negociatave të Shqipërisë

me BE. Sado i mirëpritur është ky kompromis, ai deri tani ka zgjidhur vetëm çështjen procedurale. Tani Bundestagu do të shohë edhe përmbytjen që do të dalë nga kjo marrëveshje, bëhet e ditur nga qarqet kristiandemokrate dhe kristiansociale në Bundestag. Këtu ia vlen të kujtohet se kushti i dytë i rezolutës së Bundestagut kërkon nga reforma zgjedhore që ajo të bëhet në përputhje me kushtet e OSBE/ODIHR-it, por edhe që ligji i ri të garantojë një “financimin transparent të partive dhe fushatave zgjedhore”

dhe të marrë parasysh rezultatet e komisionit “ad hoc” për reformën dhe rekomandimet e ODIHR-it, në 5 shtator 2019. Por Bundestagu ka vendosur edhe shtatë kushte të tjera që duhen plotësuar deri në hapjen e kapitullit të parë të negociatave. Megjithatë, ende nuk dihet aktualisht se a do të bëjë BE-ja ndryshime në procedurën aktuale të zgjerimit, nisur nga fakti që presidenti francez Emmanuel Macron nuk qëndron pas procedurës aktuale të zgjerimit.

Ai ka dalë me një propozim të vetin, ku parashikon një anëtarësim me shtatë etapa. Në fund të janarit Komisioni do të dalë me një propozim të ri për procesin e zgjerimit, bazuar në propozimet e presidentit francez. Qarqet pranë CDU/CSU në Berlin i thanë Dë se dakordësimi me Francën për procedurën e zgjerimit nuk pritet të ndodhë para samitit të Ballkanit Perëndimor në Zagreb, pra , në maj të këtij viti. Së fundmi, Franca kishte dhënë sinjale se po e rishikon qëndrimin e saj për të zhblokuar hapjen e negociatave. Në një takim që pati në Paris me kryeministrin kroat Andrej Plenković, (7.01.2020), Macron tha se “Franca uron që Samiti i Zagrebit të jetë një moment uniteti dhe një sukses për Europën”./DW

Basha garanton shqiptarët:

Fillimi i betejës, ka vetëm një qëllim



Në një deklaratë për mediat, Basha theksoi se “Pavarësisht prej propagandës së shfrenuar të atij që për 4 muaj anashkaloi kushtet e Bundestagut, Reforma zgjedhore nuk do të diktohet nga qeveria e dalë me votat e blera dhe pseduopozita e blerë me paratë e krimit dhe oligarkisë”.

Sipas Bashës, tre konkluzionet mes palëve, nuk u arritën për shkak të zemërgjerësisë së palës tjetër, por u arritën për shkak të presionit ndërkombëtar për të shtyrë para axhendën e shëndoshjes së demokracisë dhe dhënies së shqiptarëve shansin e votës si cdo vend tjetër evropian.

“Falenderim të thellë për Bundestagun gjerman, SHBA dhe BE, në veçanti për ambasadorin britanik mes të cilit u vu në lëvizje mekanizmi që

coi në plotësimin e tre kërkesave të opozitës. Jam këtu për të garantuar shqiptarët, demokratët, mbështetësit e opozitës së bashkuar, socialistët e zhgënjyer, rininë shqiptare se procesi që do të nisim ka vetëm një qëllim të kthejë lirinë e votës të kthejë mundësinë që cdo shqiptar të vendosë qeverinë që do, kryebashkiakët që do, parlamentin që do e t'i shkarkojë ata me votë të lirë si në cdo vend evropian. Nuk bëhet beteja as për karriget tona, as për fatet tona politike, i dogjëm mandatet për të treguar se demokracia ishte në grahmat e fundit, sakrificat e mandateve të djegura solli atë që çdokush e konsideronte të pamundur, vetëdijësimin e përditshëm se Shqipëria ka nevojë për vëmendje dhe ndihmë”.



Opozita rinis protestat, tubim kombëtar në muajin shkurt

Kolegji i Kryetarëve të Partisë Demokratike ka vendosur në mbledhjen e datës 15 janar 2020 rikthimin e protestave opozitare.

Në vendimin e drejtuesve të PD është përcaktuar muaji shkurt si koha e mbajtjes së një proteste të madhe kombëtare.

Mësohet se kërkesa për protestë ka ardhur nga drejtuesit e degëve të PD. Datat 20 ose 22 shkurt shihen si mundësia e mbajtjes së tubimit kombëtar.

Kujtojmë se ky takim vjen një ditë pas marrëveshjes me maxhorancën për ulje në një tryezë për reformën zgjedhore, kjo e fundit si një nga kushtet e vendosura nga Bundestagu për çeljen e negociatave. Baza demokrate dhe krejt partitë opozitare insistojnë se me kryeministrin Rama nuk mund të ketë kurrë marrëveshje, pasi ai mashtron dhe fiton nga pazaret në tavolinë. Demokratët e bazës shpjeguan se duhet përballje me qeverinë Rama.

Bulqiza shfrytëzohet prej 72 vitesh dhe prapë nuk shteron.
Një vend që e ka bekuar natyra dhe historia, përjeton dhe
vdekjen e vet, po të mendosh se nga viti 2014, në pesë vite...

reportazh



Bulqiza, dritë

NGA NDUE DEDAJ

Është 28 dhjetori i vitit që sapo uli siparin. Jemi nisur drejt Bulqizës me dëshirën për të lexuar sadopak të nesërmen e minierës-qytet, teksa e sotmja është jo pak e trishtë. Natyrisht që Bulqiza nuk është një vogëlushe, larg në male, që pret një shportë me dhurata nga plaku i Vitit të Ri, që në këtë rast i bie të jetë qeveria, por që të gjithë të përmbushin detyrimet ndaj rajonit industrial minerar më të rëndësishëm të vendit: shteti, sipërmarrjet e kromit, sindikatat, shoqëria civile, donatorët e projekteve të zhvillimit të zonave rurale, pasi Bulqiza nuk është vetëm kromi i nëntokës, por edhe agroturizmi etj.

Mbërrijmë, pa shkuar ora dhjetë, në Qafën e Buallit, që kridhet nën një diell të ftohtë, kurse maja e mali të Duriçi është larëzuar nga bora, që na sajdis me fluria të rralla. Termometri shënon dy gradë nën zero. Këtu merr rruga për në Krastë e Bizë të Martaneshit, por një herë tjetër do të udhëtojmë asaj ane, edhe pse një i njohuri ynë na thotë: “S’keni ç’bëni më atje, është mbushur me hidrocentrale, sa të vrasin sytë”. Rruga e Arbërit, pasi lë prapa Urën e Vashës, të vjetrën e të renë, do të përshkojë lugun e Planit të Bardhë, Bulqizën, Fushën e Vajkalit, Shupenzën etj., duke qenë një nga rrugët më panoramike të Shqipërisë. Por tregues i saj në Bulqizë tash për tash është vetëm tuneli i papërfunduar në Qafë-Buall dhe gjurma e trasesë së rrugës. Duket e pabesueshme, por nga Kinostudioja e deri në Bulqizë, nëpër rrugën e re, do të jenë veçse 40 kilometra, kurse deri në doganën e Bllatës bëhen 70. Atëbotë, Dibra do të jetë një lagje e Tiranës, do të marrë një kuptim të ri dhe vetë

“Rruga e Dibrës”. Kohë më parë, një grup prej njëzet vetësh ndër-morën një rrugëtim të pazakontë për kohën e sotme, nëpër gjurmën e Rrugës së Arbërit në ndërtim, nga Klosi në Zall-Bastar të Tiranës, edhe si një kujtesë për gjyshërit e tyre që e kishin pasur atë rrugën e jetës. Kështu e nisim ditën tonë bulqizake, në kërkim të një reportazhi për këtë vend e këta njerëz. Le t’i shohim e prekim gjerat nga afër.

Qyteti është gjallëruar nga ardhja e emigrantëve. Pyesim për banorët dhe na thonë se në letra janë rreth 40 mijë, por vetëm gjysma banojnë realisht, gjysma tjetër ka lëvizur. Bashkia ngërthen një territor mjaft të hapur, nga Martaneshi përkufi me Tiranën, në Trebishtin kufitar me Maqedoninë e Veriut, dy orë e gjysmë larg nga Bulqiza. Mjafton dhe ky fakt për të kuptuar se reforma territoriale nuk solli asgjë të re, të paktën në jetën e komuniteteve të tilla larg nga qendrat urbane dhe pa infrastrukturën e duhur.

Udhërrëfyesi ynë është një gazetar i ri kurajoz, Sami Curri, 25-vjeçar, që shkruan për BIRN, njëherësh veprimtar i palodhur për kauzat e minatorëve dhe banorëve, pasi nuk është vetëm kromi i nëntokës që kërkohet të sjellë shumë më shumë të ardhura për ta, por edhe mbrojtja e pyjeve, lumenjve nga hidrocentralet “kontrabandë”, duke zhveshur mjedisin nga drurët dhe bimësia tjetër, si në rastin e Liqenit të Zi, nga më të bukurit e këtyre bjeshkëve.

KRONIKA E GJALLË DHE E VDEKUR E NJË MINIERE

Bulqiza shfrytëzohet prej 72 vitesh dhe prapë nuk shteron. Një vend që e ka bekuar natyra dhe historia, përjeton dhe vdekjen e vet, po të mendosh se nga viti 2014, në pesë vite, ka 27 të renë në minierë. Në qytet të zë syri një shtatore të minatorit të djeshëm, po dhe një obelisk në nderim të minatorëve të shumë që i mori e nuk i ktheu më nëntoka. Elegjia e tyre është një peng i minierës dhe familjeve. Miniera “Golgotë” ka kryqëzuar



shumë vetë, duke i shuar njërin pas tjetrit, si në një kronikë vdekjesh të paralajmëruara.

Tranzicioni i mbylli minierat e tjera të vendit, mbeti vetëm Bulqiza. Shfrytëzimi i kromit do të bëhej përmes sipërmarrjeve të shumta. Shteti, në pamje të parë, ishte dorë-jashtë, pasi ishte sipërmarrje e lirë, por jo qeveritarët e radhës. Samiu na njeh me kronikën e gjallë dhe të vdekur të minierës. Janë 2100 punëtorë që hyjnë dhe dalin çdo ditë në pusët dhe galeritë e kromit në Bulqizë dhe Martanesh, por janë dhe një dy apo treqind që punojnë në të zezë. Fabrika e pasurimit ka zbritur në 100 punëtorë. Ngjitemi deri te Pusi kryesor, pastaj vijmë “katet” e tjera të minierës, shpatëve gri të Duriçi, zona e Parë, zona D etj. Sheshin e vogël, ku tubohen vazhdimisht punëtorët për të drejtat e tyre, na vjen ta quajmë “Sheshi i Protestës”. Ata janë mbledhur dhe sot, në një sallë në qytet. Lajmi jo i mirë është se kryesuesit e sindikatës së re: Elton Debreshi, Beqir Duriçi, Behar Gjimi dhe Ali Gjata janë pushuar nga puna. Ende sindikatat e mirëfillta nuk kanë terren ndër ne. Mund të majmen me pronat publike vetëm ato sindikata që u fërkojnë supet pushtetarëve dhe vegjetojnë nën hijen e partive. Në Bulqizë e Martanesh operojnë 37 subjekte të shfrytëzimit të kromit, ku kompania kryesore është “Albchrome”, me më shumë se 600 punëtorë. Siç thonë këtu, miniera është si një lëmë që vetëm merr e nuk vë, çka do të thotë se nuk ka një plan për perspektivën se si do të rrojnë këta njerëz, kur të mos ketë më krom.

Njëri nga bashkëbiseduesit thotë se shteti nuk iu kërkon sipërmarrësve të kësaj “mbretërie” minerare të investojnë për komunitetin, në përmirësimin e jetesës së tyre. Duket se formula kapitaliste e kohës është “kap ç’të kapësh”, pa dashur t’ia dish se prapë këtu do të ketë njerëz sot e mot. Bulqiza ka gazetën dhe televizionin e vet dhe, si gjithkund tjetër, një kioskë të vocërr ku shiten

gazeta, por nuk ka librari, po folur për qendra kulturore-argëtuese, galeri arti, pse jo dhe teatër. Qyteti nuk mund të jetë vetëm shtrimi i rrugëve dhe shesheve me pllaka dhe disa shëtitore e lulishte. Në bazë të ligjit, 5 për qind e të ardhurave nga renta minerare shkojnë për pushtetin vendor për investime, por dhe këto nuk mbërrijnë të gjitha, për shkak të burokracisë së organeve financiare të qendrës, të cilat janë dorërrudhura kur është fjala për bazën. Megjithatë, specialistët shohin dritë në fundin e tunelit. Në një intervistë dhënë gazetës “Bulqiza”, inxhinieri markshejder Kujtim Aliu thotë se traversbangu i ri Shëngjin-Bulqizë (7310 metra i gjatë) dhe hapja e pusit numër 9 do t’ia shtojnë jetën minierës edhe për disa dhjetëvjeçarë. Traversbangu mbledh ujërat në thellësitë e nëntokës, duke e shpëtuar atë nga përmbytjet në raste shirash të shumtë, lehtëson transportin e mineralit etj. Edhe shtypi promocial është optimist për të nesërmen e minierës, ndërsa përgjithësisht mediat e tjera janë kritike sa i përket menaxhimit të sotëm të minierës dhe sidomos ndaj asaj çka (nuk) bën qeveria për të.

Ka pak investime në Bulqizë, të thonë, pasi paratë e kromit më shumë shkojnë në Tiranë. Miniera është këtu, por “frerët” e saj tërhiqen prej andej, si të asaj mushkës, që vetëm duhet të mbajë mbi kurriz, pa bërë fjalë. Ndaj minatorët tubohen rregullisht, protestojnë prej vitesh, edhe pse më “kryengritësit” pushohen nga puna. Problemi është kompleks, nuk janë vetëm kushtet më të mira të punës dhe pagat më të larta, kërkesa që në minierat shqiptare nuk kanë rreshtuar qysh prej grevës së njohur të minatorëve të Rubikut, në gusht të vitit 1938, por fati i “floririt” të nëntokës. Dihet se ashtu si nga deti duhet të përfitojnë të gjithë shqiptarët, edhe nga kromi i Bulqizës apo pyjet e Pukës duhet të përfitojnë po të gjithë. Por me sa duket, nga pasuritë kombëtare



në fundin e tunelit...



përfitojnë vetëm një dorë oligarkësh, siç po quhen përherë e më shumë në zhargonin politik e mediatik, një kategori sipërmarrësish të përfolur për aferat me qeverinë.

Nëntoka e pasur nuk ka mjaftuar për ta bërë Bulqizën një nga zonat më të pasura të republikës, pasi pasuria e saj shfrytëzohet për të tjerët, si dje nga socializmi, si sot nga kapitalizmi. Si me “nënë”, si me “njerken”, Bulqiza dhe bulqizakët, përherë të varfër! Kanë shkelur këtu krejt njerëzit e rëndësishëm të shtetit, të kohës së vjetër dhe të kohës së re dhe prapë Bulqiza ka mbetur mes varfërisë dhe vdekjeve.

Miniera ka historinë e saj. Deri në '90-n, kishte 5000 punëtorë, me një kapacitet prej 12 000 tonësh në muaj. Isuf Curri, gjyshi i Samiut, ishte ndër minatorët e parë të minierës, më 1948-ën, bashkë me minatorët e Rubikut, të cilët erdhën për të dhënë përvojën e tyre, ndër ta dhe Pal Marka Deda, që në vitet '70, kur ishte drejtor miniere në Spaç, do ta përpinte jo nëntoka, por burgu i Burrelit. Po ashtu, inxhinieri i shquar Todo Manço, një nga “legjendat” e gjalla të minierës. Na kujtohet kopertina e një libri ku ai paraqitej me veshjen e minatorit dhe kandilin e karbitit në dorë...

Bulqiza sot është një qytet me mbi 10 mijë banorë. Në fillim u ndërta Bulqiza e vjetër dhe në gjysmën e dytë të viteve '80, Bulqiza e re. Në qytetin e vjetër është dhe një oxhak, që mendojnë ta bëjnë monument, por dhe një “hangar” me dy-tre automjete të rrënuara, që të kujtojnë kohën e socializmit. Kohët kapërthehen çuditshëm. Afër damës së fabrikës së pasurimit, një burrë ndanë rrugës mbledh copa kromi, si dhjetëra të tjerë, përfshi dhe gra e fëmijë, që rrojnë me “frutat” e nëntokës. Si duket e kanë bezdisur gazetarët duke e fotografuar, si një “kavie” për publicistikën e tyre, ndaj nuk do që të fotografohet. Me një çekiç thyen gurët për të nxjerrë një kësulë krom. Si një bari i mirë shpirtëror, afrohet dhe i zgjat dorën ipeshkvi i dioqezës

së Rrëshenit, imzot Gjergj Meta (që mbulon dhe Matin, Bulqizën e Dibërën), por njerëz si ky kokrrues i thërtimeve të kromit kanë nevojë në radhë të parë për shtetin si “bari” i tyre.

VALIKARDHË, NË GJURMË TË SKËNDERBEUT

Emigrantët, ashtu si dhe udhëtarët që shkojnë e vijjnë për në Peshkopi e Dibër të Madhe, e bëjnë një ndalesë te busti i Gjergj Kastriotit, sa për një fotografi. Fusha e Bulqizës, jo rastësisht ka Gurin e Skënderbeut, por ngaqë aty janë zhvilluar disa nga betejat e heroit kombëtar kundër turqve pushtues. Makina jonë fluturon fushës ku pesëqind vjet më parë ngarendnin kuajt e luftës. Sakaq mbërrijmë në fshatin Valikardhë. Nuk na duhet të ecim shumë, por vetëm të kalojmë Urën e qytetit mbi lumin e Bulqizës, për të parë rrënojat e një kalaje të vjetër, mbi të cilën kanë “mbirë” disa bunkerë, duke e shëmtuar historinë. Këtu mendohet se është Fusha e Torviollit, që quhet edhe Fusha e Kalasë. Tej është Kulla e Skënderbeut dhe në anën veriore të tij, mali tjetër binjak, ai i Temlës, që sipas vendasve, vjen nga fjala tempull i perëndisë. Mësuesi i ri i historisë, Gazmir Sejdi, na e shpalos me pak fjalë historinë e hershme të Valikardhës, që vjen nga grykë/fushë e ngushtë. Ai dhe Ardian Ibrahim, një tjetër vendas i diplomuar për histori, na tregojnë edhe për 6 kishat e këtushme në rrënoja e toponime, si Kisha e Vokajve, Kisha e Ballajve, Kisha e Allushëve etj. Njihesh me këtë guidë monumentesh që mezi iu duken gjurmët, ndërkohë që kërkon me sy se ku mund të shtrihej qyteti antik? Ai ishte në rrënojat e lashta të vendbanimit, si dhe ato të kalasë e kishave të vjetra, në muret afër bregut, që i ka përparë kohë pas kohe lumi i Bulqizës, për të cilin gjithashtu është frika e banorëve se do të ketë fatin e lumenjve të tjerë, që po të futen në tuba të mëdhenj...

Shpjeguesit tanë ishin të shqetë-

suar se nuk po bëhet asgjë për ruajtjen e monumenteve të trashëgimisë kulturore.

KULLA E AGROTURIZMIT “HUPI”, NË FUSHË-BULQIZË

Një nga stacionet e reja të Bulqizës tash është dhe kulla-bujtinë “Hupi” në fshatin Lepurakë të Fushë-Bulqizës. Katër vëllezërit Hupi patën ndërtuar katër kulla. Tranzicioni, si kudo tjetër, e boshatisi jo pak fshatin, por ndër ato që nuk iu dorëzuan braktisjes është dhe njëra sosh. E kthyer prej katër vitesh në bujtinë turistike, kulla “Hupi” këtë verë ka pritur mbi 600 turistë të huaj, një grup amerikanësh etj., si dhe plot vendas. Mbase askund më mirë se në këtë kullë bujare dibrane nuk merr kuptim ai që quhet “turizmi familjar”, të shërbyerit e një kuzhine tradicionale etj. Dhe protagonist i gjithë kësaj është djali i shtëpisë, i riu 33-vjeçar Lulzim Hupi, i njohur nga publiku përmes emisioneve të ndryshme televizive, si “Histori shqiptare” të Alma Çupit etj. Por më mirë, ai njihet në vatrën e tij...

E kanë vizituar bujtinën disa gazetarë, por dhe Altin Prenga i Mrizit të Zanave, për ta inkurajuar. Është ngjitur deri këtu për ta mbështetur, humanistja austriake Marianne Graf, si një ringjallëse e kullave të vjetra shqiptare. Ka qenë dhe Kryeministri Rama, pasi bujtina e Lulzimit quhet një histori suksesi në Bulqizë, sa i përket agroturizmit. Pronari i saj ka një vizion dhe projekt të qartë se ku do të arrijë, por nuk është vetëm në dorën e tij, ka ende pak mirëkuptim e aq më pak mbështetje, duke filluar nga vendasit e deri te zyrtarët e shtetit. Ai thotë se agroturizmi nuk bëhet vetëm me bujtinën e tij, por dhe me pjesëmarrjen e banorëve të tjerë të fshatit, pasi dikush prodhon

perimet e dikush bulmetin, dikush mbarështon dhinë e kecat e dikush pulat, në funksion të bujtinës, por edhe të resorteve turistike, që mund të ngrihen në të ardhmen. Synon përherë e më shumë cilësi, përherë e më shumë njerëz. Këtë vit që sapo kemi hyrë, në pranverë e mbrapa, shpreson për një mijë turistë. Gatuan nëna e tij Sofia, 69 vjeç. I ati, Veliu, që ka punuar sondist nëntokë, nuk jeton më.

Gjyshi i tij, Jonuz Hupi, me prodhimet e bashtinës së vet merrte rrugën e gjatë me kafshët ngarkuar dhe i shiste në Tiranë. Ai e kishte merak një dyqan të vetin dhe si për t'ia përmbushur amanetin, i nipi e ka hapur një të tillë në Bulqizë, që ndihmon bujtinën të mëkëmbët pak nga pak. Po bie nata dhe bashkë me ipeshkvin Gjergj Meta marrim rrugën e kthimit për në Rrëshen. Prej dy vitesh e gjysmë, ai është jo vetëm “abati” i Mirditës, por dhe i këtyre territoreve verilindore, që dikur përfshiheshin në dioqezat sufragane (në varësi) të kryepeshkvisë së Durrësit, si Kunavia, Lisi e Stefaniaka. Urojmë dhe shpresojmë ditë më të mira për Bulqizën, Martaneshin, Dibërën etj., jo thjesht duke pritur që me Rrugën e Arbërit të ndodhë mrekullia. Shpresa është njeriu vendës i përgatitur për ndryshimin. Dhe ne fatmirësisht takuam disa nga ata, gazetarin e ri Samiun, sindikalistët e rinj të paepur në misionin e tyre, menaxherin e bujtinës “Hupi”, Lulzimin, imamin e xhamisë së Bulqizës, Andi Topin, që jep ndihmesën e tij edhe për shoqatën e jetimëve, drejtorin e shkollës 9-vjeçare, Gazmirin, i pasionuar pas historisë etj. Njerëz që e duan progresin e vendlindjes së tyre dhe përpiqen për të.

(Gazeta “Panorama”, 13 janar 2020)



Ismail Keta nuk është vetëm një kampion bote, por edhe një njeri shpirtmadh, me ndjesi të larta humane

aktualitet

Kampioni i Botës Ismail Keta sjell paisje për klinikën stomatologjike të spitalit Bulqizë

HALIL RAMA

Janë të rrallë sportistët shqiptarë që kanë arritur një sukses të tillë në arenën ndërkombëtare sa ka korrur Ismail Keta, kampion i botës në Tai e Kik Boks. Po jo vetëm kaq. Atë e karakterizon shpirti human, ndaj dhe vitin e Ri 2020 e fillon me një angazhim të lodhshëm por te kanaqur!

Gjate kontaktit me djalin dashamirës të Bulqizës Sami Curri, kampioni Keta kishte mësuar që në spitalin e qytetit minator në zemër të maleve është i punësuar një Dr. Stomatolog, por nuk ka pajisje-klinike.

Për momemtnin solli në kujtesë që kur ishte i vogël i dhimbte dhëmbi shumë, dhe ne mesnatë pranoi t'ia heqë komshiu plak me darnat e kalit (!!)

Ndaj, tashmë që, falë pasionit e talentit është bërë i njohur në gjithë botën, nuk mund të rrinte pa e bërë realitet ofertën e mikut gjerman (Dr Punkel që do të dilte në pension) duke i dhuruar të gjitha pajisjet e klinikës së tij për vendlindjen, Bulqizë.

“Një ditë e lodhshme dhe për mua, Gjetanin dhe Ajetin, por një film i gëzuar i 2020-tës, pasi Bulqiza së shpejti do të ketë edhe një Klinikë dentare për shërbime falas (mbi të gjitha për fëmijët. Faleminderit Dr Punkel. Zoti qoftë me Ju dhe familjen tuaj”, shkruan kampioni Keta në një status në faqen e tij në facebook, ndërsa uron që për këto pajisje të mos ju dalin probleme me doganat në Shqipëri!!!

Ismail Keta ka lindur në fshatin Koçaj të Bulqizës. Ai është ushtruar vazhdimisht me sport dhe në shtëpinë e tij gjen ende si relikte thasët e rrës, litarët dhe pjesë të



vagonëve që shërbenin si shtangë. Në vitin 1997 kalon në Gjermani dhe punon fillimisht në një diskotekë në Vilzburg si “security”. Aty bie në sy të personaliteteve të sportit, që e nxisin të ushtrohet në disiplinën e tai e kik boksit. Fillon vullshëm stërvitjen dhe shumë shpejt bëhet kampion i Gjermanisë, titull që e mban deri në vitin 2022, kur dëmtohet. Në vitin 2001 doli nënkampion bote në këtë disiplinë dhe ky ishte një sukses i madh për të. Në ndeshjen kur doli nënkampion bote nuk kishte në pallat të sportit asnjë shqiptar dhe ai paguan një austriak 100 dollarë që të mbante flamurin shqiptar.

Në dhjetor 2012, Ismail Keta ka rifituar titullin kampion bote në Kik dhe Taj boks. Ai ka mundur në Dyseldorf të Gjermanisë, në raun-

din e 3-të me nokaut, holandezin Remo Arnst.

Ismail Keta nuk është vetëm një kampion bote, por edhe një njeri shpirtmadh, me ndjesi të larta humane. Nuk janë të paktë shqiptarët që kanë gjetur strehë në shtëpinë e Ismailit në Mynih. Madje ai ka ndihmuar në të holla mjaft qytetarë shqiptarë që të vizitohen e mjekohen në spitalet e Gjermanisë, duke qenë një shembull model për të gjithë. Bulqiza, me të cilën Ismaili është fort i lidhur, ndihet krenare që ka një sportist kaq të talentuar të dalë nga gjiri i saj. Një kampion bote është nuk mund t'i përkasë gjithësesi vetëm një zone, por të gjithë shqiptarëve.

Gjermania e vlerëson për vlerat e tij si sportist, por edhe si një përkrahës dhe zhvillimit të sportit, duke i krijuar lehtësira, ndërsa në Shqipëri, vëllezërit Keta, aq të njohur në disiplinën e tai e kik boksit, që të dy sportistë super të talentuar dhe kampionë në kategoritë përkatëse, nuk kanë marrë mbështetjen e duhur e të merituar të strukturave të sportit në vendin tonë.

Kur Gjetan Keta fitoi turneun ndërkombëtar në Tiranë në vitin 2007, shumë institucione të sportit bënë veshin e shurdhët, por pati dhe nga ata që inkurajuan dhe nderuan me pjesëmarrjen e tyre si kryetari i Akademisë së Shkencave Gudar Beqiraj, ish-drejtori i sporteve në MTKRS Mehmet Spahiu apo dhe drejtori i programeve në TVSH, Bajram Hoxha. Vëllezërit Ismail e Gjetan Keta janë një krenari e Bulqizës dhe e sportit shqiptar në përgjithësi.

Mjafton të kujtojmë që pallatet e sportit në Gjermani mbushen plot në ndeshjet e ata zhvillojnë për të parë famën sportive që kanë arritur dhe, atë që është më kryesorja, dalja e tyre në ring vazhdimisht



me flamurin shqiptar, duke i bërë ata ambasadorët de fakto të sportit shqiptar në Gjermani. Ndoshta është momenti që edhe KOKSH-i apo strukturat drejtuese të sportit në MTKRS të ndërgjegjësohen për të respektuar kampionin e botës Ismail Keta, i cili do të jetë brenda pak ditësh në Tiranë, i ftuar në darkën e “Mbrëmja e Kampionëve” që organizohet në këtë fundviti.

Ismail Keta është i martuar dhe ka një djalë. Emri Gjergj (Kastrioti Skënderbeu) i të birit është mjaft domethënës për qëndrimin e kampionit të ri të botës dhe origjinës së tij. Keta është mjaft i ndjeshëm ndaj vendlindjes së tij, Bulqizës dhe në të ardhmen ka në projekt të ndihmojë fëmijët që kanë mbetur jetimë si pasojë e humbjes së prindërve në minierën e Bulqizës. Respekti që gëzon Ismail Keta është shumë i madh dhe ai krenohet me përkatësinë e tij, duke qenë një shembull i familjarit të devotshëm dhe i dashurisë për vendlindjen.





Bujar Kapexhiu dhe Folk Alb “Hazis Ndreu”

• *Nën kujdesin e Presidentit të Republikës, z.Illir Meta, Ansambli Folk Alb “Hazis Ndreu”, së shpejti do të marrë pjesë në një eveniment të rëndësishëm tek arbëreshët e Italisë, në javën e kulturës arbëreshe*

HALIL RAMA

Vlerat dhe madhështia e një personaliteti publik konsistojnë para së gjithash në marrëdhënjet me njerëz të moshave e profesionave të ndryshme, nga më të vegjlit e deri tek më të moshuarit. Tek respekti dhe admirimi i tyre. Më së miri këto mishërohen në veprimtarinë e artistit të mirënjohur Bujar Kapexhiu, të cilit vitin e kaluar iu shtua edhe dekorata e lartë “Nderi i Kombit”, akorduar nga Presidenti i Republikës Ilir Meta.

E kemi parë aktorin e shumë roleve në disa filma shqiptarë, edhe si regjisor, edhe si moderator spektaklesh, edhe si skenarist, karikaturist, edhe në juri të ndryshme festivalesh dhe emisionesh radiotelevizive, por edhe si basketbollist në rininë e tij të herëshme. Të gjithë e njohin këtë personazh shumëdimensional. Por ajo që e dallin nga të tjerët është karakteri shumë popullor i Bujar Kapexhiut.

Nëse në jurinë e spektaklit “Në kurthin e Piter Pan” të Tv Klan, Kapexhiu jep verdiktin e tij për fëmijën më të talentuar, këtë nuk nguron ta bëjë edhe për një shfaqje festive të Ansambilit Artistik “Folk Alb” të Kamzës, që para pak ditësh u pagëzua me emrin e “Artistit të Merituar” Hazis Ndreu – “Mjeshtër i Madh”, i cili nderohet e kujtohet si ikonë e artit dhe kulturës kombëtare.

Në nderim të kujtimit për mikun e tij të hershëm, i cili për dekada të tëra ka mrekulluar artdashësit tanë e ata të huaj (në festivalet ndërkombëtare në Moskë, Kajro, Stamboll

e Prishtinës) me këngët, rapsoditë e kërcimet e tij, Prof.dr.Bujar Kapexhiu ka forcuar miqësinë me ata që po trashëgojnë vlerat e një artisti e shkrimtari që e futi Historinë e Dibrës në shina të sigurta për të ecur me dinjitet në fushën e madhe të Historisë sonë Kombëtare. Ndaj nuk është rastësi që në përgatitjet dhe konkurimet brenda e jashtë vendit të Ansambilit Folk Alb “Hazis Ndreu”, të themeluar e drejtuar nga i biri i tij, koreografi i talentuar Avni Ndreu dhe mbesa, Earta Ndreu, të jetë i pranishëm edhe Bujar Kapexhiu. Autori i librit “Burri i odës dibrane”, njëherësh skenarist dhe regjisor i spektaklit me të njëjtin titull në 90-vjetorin e lindjes së Hazis Ndreut, prej vitesh ndjek nga afër edhe veprimtarinë e Ansambilit Folk Alb të bashkisë Kamëz. Ndjen krenari për sukseset e këtij ansambli, që vitin e kaluar u nderua me çmime të para në Festivalin “Kënga dhe vallja na bashkoi” në Plavë dhe Guci; në Festivalin Folk-Fest në Shkup, në Festivalin “Kënga jehon” në Strugë, në Festivalin Ana-Drinit, Rahovec si dhe në Festivalin Ndërkombëtar të Fëmijëve në Stamboll. Po ashtu mori pjesë dhe u vlerësua shkëlqyesh në Fest-Folk në Buzgan, Rumani. Pas këtyre sukseseve ata performuan me nivel të lartë artistik në takimin festiv me rastin e Vitin të Ri 2020 në Pallatin e Kulturës Kamëz. Ndaj dhe duke shfaqur krenari të rrallë, Kapexhiu veçoi vlerat e rralla që mbart programi i këtij ansambli, buqetën me këngë e valle të interpretuara mjeshtërisht prej artistëve amatorë, nga mosha parash-



kollore deri maturantë të shkëlqyer. Këto vlera do të evidentoheshin më së miri nga Presidenti i këtij Ansambli, z.Muahrrem Gjoka. Vetëm para një muaj, në 70-vjetorin e Ansambilit “Kuvendi”, Zall Dardhë, Muahrremi do të spikaste si kryesori në vallen epike të burrave të kësaj krahine, i karakterizuar nga forca, burrëria, trimëria, karakteri luftarak, madhështia etj.

Pasi vlerëson repertorin e Ansambilit Folk Alb “Hazis Ndreu”, Presidenti Gjoka thotë se brenda elementit kombëtar, vallet e këtij ansambli kanë mjaft veçori krahinore. Si një ekspert shumëvlerësh ai pohon se veçantia e valleve vërehet në motivet, formacionin dhe trajtën. Në këtë aspekt ai vlerësoi vallen me motive të Jugut të kërcyer aq mjeshtërisht nga grupi i fëmijëve të vegjël, vallen me motive të Matit, si dhe ato me motive arbëreshe e nga Tropoja, të luajtura me vrytuoze nga grupi prej më se 30 kërcimtarësh, djem e vajza të rritura, ku veçon si më të mirët: kompozitorin Xhelil Imeraj, administratorin Earta Ndreu, asistent koreografin Erida Statana, njëherësh valltare dhe

këngëtare shumë e talentuar si dhe këngëtarin Zaim Tollja. Mbresëlënëse që edhe një zë i veçantë i vokalit shqiptar, tenori Dardan Pepkolaj, i cili ka kënduar në dhjetra skena, por dhe në stadium kur kombëtarja jonë ka zbritur në fushë. Valltarët e këtij ansambli sollën para publikut, në mënyrë origjinale një dasëm tiranase si dhe vallen tropojane nën ritmet e këngës “Kuç e zi”. Muahrrem Gjoka që i ka mbështetur me shumë dashuri të gjitha aktivitetet e këtij ansambli, njeri human dhe me zëmer të madhe, por dhe veteran i folklorit, me modest falenderon dhe kontributorët tjerë në këtë ansambël, bashkinë Kamëz e veçanërisht nënkryetarin, avokat Hasan Bara si dhe gazetarin e mirënjohur sportiv, njëherësh moderator i dhjetra veprimtarive, spektakleve e promovimeve, Defrim Methasani.

Siç u bë e ditur në këtë takim festiv, Ansambli Folk Alb “Hazis Ndreu”, së shpejti do të marrë pjesë në një eveniment të rëndësishëm tek arbëreshët e Italisë, nën kujdesin e Presidentit të Republikës, në javën e kulturës arbëreshe.



Zyrtarët e financave dhe ekonomistët shikojnë me sy të kujdesshëm ndaj sistemit bankar hije të Kinës. Burimet alternative të kreditimit...

speciale

Problemet e mëdha të Evropës në vitin 2020

2019 ishte viti kur u rrëzuan disa qeveri evropiane, Boris Johnson shty-pi kundërshtarët e tij me një premtim për "Ta përfunduar Brexit" dhe një 16-vjeçare nga Suedia ndezi protestat mjedisore në të gjithë kontinentin.

Ndërsa kemi hyrë në janar, redaktorët e POLITICO kanë bërë një listë të tensioneve kryesore që do të formësojnë 2020.

EVROPA BËHET KINEZE

Nëse nuk arrin t'i mundësh, bashkohu me ta. Proteksionizmi nuk do të jetë më një fjalë e pisët në hartimin e politikave të BE-së. Pasi Britania e tregtisë së lirë largohet nga BE, Franca dhe Gjermania do ta shmangin shpejt Brukselin drejt një politike industriale bazuar në mbështetjen prej shtetit, planifikimin qendror dhe kampionët evropianë.

Kjo do të përfshijë veton mbi blerjet e mëdha kineze në Evropë dhe qeveritë evropiane duke përjashtuar kompanitë aziatike nga kontratat publike, pasi BE zgjedh gjeneratën e saj të ardhshme të fituesve të korporatave të rritur në shtëpi, në sektorë të tillë si automjete elektrike, hidrogjen dhe kujdes shëndetësor. Priten përpjekje të mëdha për bashkime në telekomunikacion dhe industri të tjera të epokës së gurit.

Kombet liberale (suedezët dhe holandezët) dhe përfutuesit e mëdhenj të investimeve kineze (Greqia dhe Portugalia) do të qortojnë gjigandin industrial franko-gjermane për hipokrizi. Por Parisi dhe Berlioni do të jenë të shurdhër ndaj ankesave të tyre. Do të jetë një kthim në ditët e supozuara të lavdisë së rindërtimit të pas Luftës së Dytë Botërore – dhe rezultatet do të jenë jo aq shpresëdhënëse.

NJË KRIZË E RE FINANCIARE

Pllakat tektonike të sistemit financiar botëror po krijojnë tension dhe një rrëshkitje madje është e vonuar. Më shumë se një dekadë – një interval tipik midis 2 gjendjeve të panikut – që nga kriza e fundit, ma-



sat mbrojtëse janë pak a shumë të ngritura kundër përsëritjes së atyre ngjarjeve. Por kriza tjetër është gjithmonë e ndryshme, siç pëlqejnë ta thonë financierët.

Zyrtarët e financave dhe ekonomistët shikojnë me sy të kujdesshëm ndaj sistemit bankar hije të Kinës. Burimet alternative të kreditimit, larg bankave konvencionale, kanë lulëzuar së bashku me ekonominë. Zyrtarët nuk e kanë marrë masën e fenomenit me një farë vetëbesimi. Ndërsa ekonomia e Kinës dridhet, kredidhënia tronditet. Edhe një rritje e vogël e humbjeve, mund të fshijë huadhënësit me "jastëkë" të hollë financiarë.

Armëpushimi në ofensivat tregtare të Trumpit është prituri me një psherëtimë lehtësie. Por paqja, dhe ekonomia e Kinës, është e brishtë. Çdo gabim politik mund të shkaktojë armiqësi të reja, që do të zbehnin perspektivat e rritjes.

Kjo vjen ndërsa dritat paralajmëruese po ndezin të kuqen në panelet e kontrollit të mbikëqyrësve të tregut dhe analistëve. Disa lloje aksionesh dhe obligacionesh po tregtohen me çmime të larta. Këto dy forca së bashku janë të gatshme të trondisin botën financiare në vitin 2020.

BREXIT BËHET EDHE MË E PISTË

Bisedimet e tregtisë pas Brexitit midis SHBA dhe BE do të bëhen të shëmtuara në vitin 2020, teksa Kryeministri Boris Johnson shtyn për më shumë liri



devijimi nga rregullat e BE-së.

Me Mbretërinë e Bashkuar tashmë pothuaj të sigurt për t'u larguar nga BE në 31 janar, kjo lë pyetjen e vështirë – çfarë lloj marrëdhënieje dëshiron të ketë Mbretëria e Bashkuar me Bashkimin Evropian. Prisni që bisedimet e tregtisë Mbretëri e Bashkuar-BE, ashtu si çdo krizë evropiane, të zvarriten deri në dhjetor 2020, teksa gjithësecili luan një lojë kolosale të pulës diplomatike.

AGJENDA E KLIMËS ZIEN

Nivelet atmosferike të dioksidit të karbonit do të arrijnë një tjetër rekord në vitin 2020. Nuk do të ketë asnjë shenjë që rritja globale e temperaturave po vihet nën kontroll.

Përkundër këtij sfondi, premtimi i Presidentes së Komisionit Ursula von der Leyen për t'u përballur me sfidën klimatike do të mbizotërojë në kalendarin e BE – duke prekur gjithçka, nga rregulloret financiare, deri tek rregullat e kimikateve, taksat e avionëve, standardet e ndotjes për makinat dhe marrëdhëniet tregtare të bllokut me pjesën tjetër të botës. Muskujt politikë që mbështesin të ashtuquajturën Marrëveshje të Gjelbër të saj, do të bëjnë që të gjithë këto të miratohen – por do të shkaktojnë disa grindje serioze këtë vit.

Njëra ka të ngjarë të ndodhë brenda Komisionit Evropian. Socialisti holandez Frans Timmermans, nënkryetari ekzekutiv i Komisionit, përgjegjës për Marrëveshjen e Gjelbër, mban përgjegjësinë politike për të çuar përpara programin, por fjetet kontrollohen nga një nënkryetar ekzekutiv rival – Valdis Dombrovskis nga Partia Popullore Evropiane. Tjetra është brenda vetë bllokut. Përpjekja për të pastruar është duke ekspozuar çarje të thella midis Përditësimit të Gjelbër të Kontinentit dhe Lindjes së varur nga qymyri. Polonia thotë se nuk mund të përmbushë një qëllim që të bëhet neutrale nga qymyri deri në vitin 2050, dhe kjo do të detyrojë BE-në të hedhë shumë para, për t'i marrë Polakët dhe aleatët e tyre në anën e vet. Por nuk ka asnjë shenjë që Varshava po planifikon ndonjë lloj transformimi rrënjësor (dhe shumë të shtrenjtë) të ekonomisë së saj.

KONTROLLIN E MERR TE-KNOLOGJIA

2020 do të jetë viti kur Evropa hedh

tutje qasjen e saj të matur ndaj teknologjive të reja.

Ndërsa blloku synon një politikë industriale të denjë për të tejkaluar rivalët globalë, do të detyrohet të përballet me realitetin që një qasje butë-butë ndaj inteligjencës artificiale, automjeteve pa shofer dhe teknologjive të tjera futuriste nuk është më e pajtueshme me ambiciet ekonomike.

Ekspertët thonë se një mori sistemesh të inteligjencës artificiale janë tashmë në përdorim në të gjithë kujdesin shëndetësor, arsimimin, punësimin dhe drejtësinë penale, pa masa mbrojtëse të përshtatshme ose struktura përgjegjësisë. Kamionë pa shofer tashmë veprojnë nëpër rrugët publike të bllokut evropian, megjithëse nën prova të kufizuara e të kontrolluara fort. Gjigandët e hapësirës ajrore si Airbus dhe Boeing, kompani të teknologjisë si Uber dhe madje edhe McDonald po bëjnë hapa të guximshme në dërgesat me dronë apo taksitë ajrore.

Edhe qeveritë evropiane tashmë janë duke përqafuar teknologjinë e njohjes së fytyrës – duke injoruar shqetësimet kryesore për privatesinë dhe lirinë civile.

**Përkthyer dhe përshtatur nga
Politico.eu - Bota.al**



Brenda disa ditësh, një organizim i këtillë fitoi vëmendjen brenda Kosovës dhe në diasporë. Atë dimër nuk kishte asnjë familje të “Ramiz Sadikut”



NGA VETON SURROI

Në këto momente mund të marrim mësim prej atyre ditëve të para tridhjetë vjetësh, kur frika ishte tjetërfare, shumë më e madhe, qe frikë për vetë ekzistencën tonë. Dhe, megjithatë, ia dolëm...

1.

Këso kohe para tridhjetë vjetësh qe shembur Muri i Berlinit dhe flamuri rumun kishte një vrimë të madhe të rrumbullakët në mes- qenë prerë nga ai simbolet e komunizmit.

Në Prishtinë kishte disa muaj që në mesin e një numri jo të vogël njerëzish zihej ideja se edhe në Kosovë duhej të ndodhte diçka e ngjashme, se ishte momenti historik kur Kosova duhej, si popujt e tjerë të robëruar në Evropë, të largohesh nga komunizmi dhe t’ia hapte rrugën demokracisë parlamentare shumëpartiake.

Qe më vështirë në Prishtinë se në qytetet e tjera të Evropës Qendrore e asaj Lindore. Kosova ishte në gjendje të jashtëzakonshme, sistemi i saj kushtetues juridik i anuluar, vendi i okupuar zyrtarisht nga Serbia. Çfarëdo përpjekjeje për t’iu shmanhur linjës, lëre më kundërvënies së drejtpërdrejt, Lidhjes Komuniste në Kosovë, quhej menjëherë separatizëm e irredentizëm, me ndëshkim imediat fizik.

U hodh ideja që të fillohet me hapjen e degës së Shoqatës për Iniciativë Demokratike Jugosllave. Organizata e themeluar nga intelektualë të njohur të ish-Jugosllavisë, mes të cilëve qe Branko Horvati, intelektual kroat i cili u angazhua publikisht për dekriminalizimin e kërkesave politike të shqiptarëve në ish-Jugosllavi.

Dhe, me t’u hedhur ideja, disi u hodh edhe njëfarë shorti që unë të isha organizatori i mbledhjes së parë të Degës në Prishtinë.

Pas shumë përpjekjeve dhe një koordinimi me njerëz në Kosovë e ish- Jugosllavi, u caktua mbledhja, u pagua salla në “Boro e Ramiz” dhe gjysmë ore para fillimit të mbledhjes

një kordon i policisë serbe rrethoi “Boro e Ramizin”, për të treguar pa nevojë të madhe fjalësh se mbledhja nuk mund të mbahej.

Kisha parandier se mund të ndodhte ashtu dhe që më herët qesh marrë vesh me kryetarin e Shoqatës së Shkrimtarëve që mbledhjen, nëse ndalohet në “Boro e Ramiz”, ta mbanim në Shoqatë. Më tha që të lajmërohem te sekretari i Shoqatës, dhe kur këtë e bëra ai i hapi dyert. Tha shkurt: “Kjo është shtëpia jonë. E të gjithëve!”.

Fjalët e tij do të merrnin rrugën e vet mitike. Ditë pas dite, vit pas viti, sekretari do ta hapte atë që ishte bërë shtëpia jonë, e vetmja që ndërsa në të kërkohej liri, konsiderohej të ishte e jona, e të gjithëve. Po, qenë ndoshta diçka më shumë se 100 metra katrorë që simbolizonin lirinë e institucionalizuar, por në formë të çuditshme, në njëfarë mënyre mjaftonin, për të treguar se liria nuk ngulfatet, se ideja e saj nuk matet me metra katrorë. Dhe, prandaj është e të gjithëve.

2.

Atë dhjetor, njëri prej punëtorëve të “Ramiz Sadikut” e kuptoi çka flisja dhe më përkrahu. Ishte njëri prej dy mijëve që ritualisht dilnin për të protestuar kundër mbylljes së kësaj ndërmarrjeje nga ana e pushtetit serb, ishte njëri prej dy mijëve që rriheshin nga policia ndërsa marshonin afër ndërmarrjes së tyre, dhe ishte njëri prej dy mijëve që ishin ngujuar në sallën e madhe të “Boro e Ramizit” me idenë që të mos dilej derisa çështja e kësaj ndërmarrjeje të mos trajtohej nga Kongresi i Jashtëzakonshëm i Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë.

Kuptoi që LKJ-ja e kishte vështirë ta shpëtonte Jugosllavinë e lëre më “Ramiz Sadikun”, dhe iu ndezën sytë me mendimin e dëgjuar, se ky tubim do të mund të ishte nismëtar për sindikatat e para të pavarura në Kosovë, madje në ish-Jugosllavi.

Ai u bë njëri prej nismëtarëve, njëri prej anëtarëve të Kryesisë dhe

Tri rrëfime të para tridhjetë vjetësh

njëri prej aktivistëve më të zellshëm e të zëshëm.

Brenda disa ditësh, një organizim i këtillë fitoi vëmendjen brenda Kosovës dhe në diasporë. Atë dimër nuk kishte asnjë familje të “Ramiz Sadikut”-që të gjithë të përjashtuar nga puna- që do të mbeste pa miell, vaj, dru për ngrohje.

Ai dhe shokët e tij nxorën në pah diçka që kishte ekzistuar brenda nesh, por nuk ia kishim ditur a shqiptuar emrin. Solidaritet. Apo bashkëvuajtje. Apo ndoshta njësim, ndjenja se në atë që duhej të ishte shtëpia jonë, vuajtja e çdo njërit eventualisht do të jetë vuajtja jonë personale.

3.

Nuk i shkrova emrat e sekretarit dhe të punëtorit të “Ramiz Sadikut”, sepse janë të këtillë, të harruar. Historia është shkrim në kontinuitet dhe pasurohet jo domosdoshmërisht me të vërteta. Si çdo shkrim tjetër që ka për motër fiksionin, ka nevojë për heronj dhe mite. Sekretari e punëtori i “Ramiz Sadikut” nuk janë pjesë e mitit, sepse nuk janë shndërruar në personazhe heronjsh.

E, megjithatë, ata janë historia e vërtetë e këtij vendi, së bashku me qindra e mija njerëz të tjerë që këtë e kanë konsideruar dhe e konsiderojnë se është shtëpia jonë, dhe se vuajtja e çdonjërit në atë shtëpi eventualisht do të shndërrohet në vuajtje të të gjithëve.

Ekziston ende në shoqërinë kosovare garë për pozicionin në rrëfimet historike; madje çdo ditë, edhe sot, e kemi të njëjtën garë. Në shumicën e demokracive të konsoliduara parlamentare ndarja e dikastereve në Qeveri apo posti i Presidentit lidhen me projekte e ide që kërkojnë levat e pushtetit për t’i zbatuar. Janë projekte transformative shoqërore. Në demokracinë tonë të re parlamentare ende jeton ideja se posti politik shërben për transformim personal, mes të tjerash, edhe për kalim të sigurt drejt historisë.

E, transformimin e vërtetë historik, atë të vështirë, do ta bëjnë gjithnjë njerëzit si sekretari i Shoqatës dhe punëtori i “Ramiz Sadikut”.

4.

Transformimin e bënë para tridhjetë vjetësh, në formën më të çuditshme, gazetarët. Jo me shkrimet

e veta, sepse censura e pushtetit dhe autocensura nga frika e ndëshkimit nuk lejonin lirinë e fjalës. Gazetarët e “Rilindjes” vendosën që atë rezistencë që e bënë brenda gazetës ta shpërfaqnin në publik : meqë nuk lejohej me shkrim në të, atëherë duke u bërë prijatarë në braktisjen, edhe formale të Lidhjes së Komunistëve dhe në pjesëmarrje aktive në themelimin e organizatave të reja politike e të shoqërisë civile.

Njëri prej atyre themeltarëve, Zenun Çelaj, u nderua në 80-vjetorin e lindjes së tij për vepër jetësore. Pjesa ime personale e asaj vepre jetësore qe, si e gazetarëve të tjerë të moshës sime, se qe mësuesi im i parë i gazetarisë. Pjesa e rëndësishme e asaj vepre jetësore, si për mua ashtu edhe për këtë shoqëri, janë mësimet e Zenunit: të kërkuarit e shprehjes vetjake, e ndershmërisë ndaj vetes dhe, fundja, e çlirimit nga frika.

Kjo, liria nga frika, ishte njëra prej lirive fundamentale të fituar asobote. Por, si çdo liri tjetër, është një që duhet të kërkohej, të luftohej për të, të mbrohet.

Në njëzet vjetët e fundit Kosova u çlirua nga okupatori, por, çuditërisht, menjëherë iu kthye frika.

Kjo frikë e re qe frikë nga pushtetarë e uzurpatorë të dhunshëm. Qe frikë nga padrejtësia e një shoqërie të kapur. Qe frikë nga një e ardhme ku njerëzit e paarsimuar e të paafte nuk do të mund të ofrojnë shërbimet bazike shoqërore: çfarë do të jetë inxhinieri apo mjekja e së ardhmes kur 15-vjeçari i sotëm nuk e kupton tekstin që e lexon?

Tashmë ekziston frika nga një mallkim kolektiv, sikur shoqëria jonë të jetë e parapërcaktuar të jetë e këtillë, me perspektivë vetëm për atë që largohet nga ky vend.

E ndoshta në këto momente e në këtë përvjetor mund të marrim mësim prej atyre ditëve të para tridhjetë vjetësh, kur frika ishte tjetërfare, shumë më e madhe, qe frikë për vetë ekzistencën tonë.

Megjithatë, ia dolëm. Dhe ia dolëm sepse, përtej miteve dhe figurave historike, kishte qindra e mijëra njerëz që besuan se kjo, çfarëdo që është, është shtëpia jonë dhe është shtëpi e të gjithëve. Dhe se këtë shtëpi e mbajnë vetëm solidariteti, njësimi e besimi në të drejtën e të jetuarit të lirë.

Në kujtim të dëshmorit Ramiz Hyseni nga Sopoti i Grykës së Madhe, Dibër

përkujtimore

RAMIZ HYSENI, YLLI I PASHUAR!

NGA ILIR PUCA

Dëshmori Ramiz Hyseni nga Sopoti i Grykës së Madhe të Dibrës, i cili dha jetën në moshën 29 vjeç në luftë me nazistët gjermanë në Llokëm të Maqedonisë me 3 dhjetor 1943 meriton respekt dhe mirënjohje të veçantë.

Në këtë hark kohor, prej vetëm 29 vjetësh ai jetoi dhe la gjurmë. Në moshën 4 vjeçare përfitoi tragjedinë më të madhe që mund t'i bjerë për fat një fëmije: - Brenda një jave i vdiqën fillimisht e ëma dhe 6 ditë pas të ëmës i vdes edhe babai!

Babai i Ramizit, Mehmeti, kur e pa se edhe për të po afrohej çasti me e lanë këtë jetë thirrri pranë vetes gruan e Shaban Hysenit dhe i tha: - Po të lë amanet Ramizin! Mos ma ndajsh prej Lëjfs (vajzës së Shabanit)! I sigurtë që amaneti do t'i kryhej siç e deshte vetë, dha shpirt. Mehmeti me Shabanin ishin kushurinjtë parë.

Që të dalë sa më i plotë portreti i Ramizit është e domosdoshme që të njihemi edhe me rrethin e tij familjar, ambient në të cilin, lindi, u rrit dhe u brumos dëshmori i ardhshëm. Fisi Hyseni në Sopot, pa qenë në gjendje me dhënë kohë të saktë, fillimisht rezultoi me mbiemrin Osmani. Një fakt të tillë e përforcon edhe e dhëna që në listën e pronave të kësaj familjeje, Osmani, ose afër pronave të familjes Hyseni edhe sot egzistojnë toponimet “Muçila e Osmanjet” afër zabeleve të Hysenjet në zabelet e Kishës, në Libaraz, ose “Livadhi i Osmanjet” afër Arës së Hysenjet në Zall Sopot (Livadhi i Osmanjet është aty ku sot ka shtëpinë Suri Puca). Më vonë, konkretisht në vitin 1931, rezultoi me mbiemrin Demiri. Ky fakt pasqyrohet në aktivitetin e Komunës Qendër Zerqan kur në vitin 1931 Kryetar i kësaj Komune ishte Isa Demiri i cili nuk është tjetër përveç se Isa Hyseni – nga Sopoti. Përsëri, pa qenë në gjendje me përcaktuar vitin e saktë, mbiemri i familjes Demiri ndryshon në Hyseni. Në realitet Isaja mori për mbiemër emrin e babait të tij Hysenit. Këtë mbiemër e morën edhe dy vëllezërit e tjerë: - Malja (Ismaili) dhe Bajrami. Që të tre ishin djemt e Sali Osmanit. Malja la Mehmetin, Hyseni la Isanë, Bajrami la Shabanin. Pra Mehmeti, Isaja dhe Shabani – ishin kushurinjtë parë. Mehmeti la Ramizin, Shabani la Rifatin dhe Lëjfen kurse Isaja nga 9 fëmijë – nuk i rroji asnjë. Pra Ramizi me Rifatin & Lëjfen ishin kushurinjtë dytë. Për Ramizin ishte një humbje e pazëvendësueshme por edhe trullësëse . Por nuk thonë kot: “Zoti edhe të bie por edhe të mba”! Pra fati nuk e braktisi totalisht sepse për të u kujdesën Shaban & Isa Hyseni me gratë e tyre. Thonë se në jetimin nuk bie diell e hanë por ndaj Ramizit Zoti u tregua zemërgjërë sepse atë që i mungoi nga prindërit biologjikë e gjeti tek Shabani dhe Isaja e tek gratë e tyre. Të dyja gratë derdhën tek Ramizi të gjithë potencialin e tyre të dashurisë e të dhimsurisë mëmësorë, - gruaja e Shabanit e motivuar nga amaneti që i ishte lënë e që ajo i kishte dalë për zot kurse gruaja e Isasë e nxitur nga mungesa e pasardhësve biologjikë, nga 9 fëmi të lindur nuk qe kismet me i jetuar asnjëri , kështu që të gjithë dashurinë e saj si nënë e derdhi pa kursim tek Ramizi. Në këto kushte, Ramizi, ndonëse u rrit me përkëdheli nuk rezultoi i lastuar e as u lejua që të marrë rrugë të gabuar. Ramizit iu dha liri e plotë dhe hapsirë e gjërë ku kishte mundësi t'i zhvillonte prirjet natyrale por gjithmonë nën kontrollin dhe kujdesin e Isa e Shaban Hysenit të cilët edhe ishin njerëz me kulturë ngaqë kishin rrahur edhe rrugën e kurbetit në Stamboll. Në këto vajtje,



në Stamboll, Isaja edhe arsimohet e ky fakt u shfrytëzua nga autoritetet e kohës ngaqë, siç e thamë edhe më sipër, Isaja emërohet Kryetar i Komunës Qendër Zerqan (Fatos Daci në Enciklopedia e Dibrës 3 f.64). Duke e trajtuar me dhimsuri por edhe me kujdes e me një vëmendje të veçantë tek Ramizi dolën në pah dhe u kultivuan tipare që jo vetëm e dallonin prej bashkëmoshatarëve të tij por i jepnin një status të veçantë dhe dominues mbi to. Me kalimin e viteve këto veti u bënë më të theksuara ngaqë përkrah këmbënguljes dhe guximit tashmë ishte në zhvillim të plotë intelektin dhe elokuenca (gojtaria = e folmja). Në mardhëniet me bashkëmoshatarët, si tek vajzat por më shumë tek djemt, kishte shumë inatë frikacakët e këtë ndjenjë (të frikës) tentonte t'ua hiqte edhe me dhunë. Pra të bënte trim me zor. Të deshte dhe të bënte ashtu siç ishte vetë: trim, guximtar, shumë i hedhur dhe i dashur sa më s'ka. Ndjenja e dashurisë ndaj të tjerëve ishte reflektim edhe i mirënjohjes ndaj dashurisë së treguar në gjirin familjar të Hysenjet dhe kjo gjë Ramizit iu bë pjesë e shpirtit të tij. Këtë ndjenjë Ramizi e derdhi në të gjitha rrethet shoqërore ku i qëlloi që të jetonte e punonte por më së shumti tek Rifati dhe Lëjffa me të cilët ishte kushuri dytë. Tek Rifati & Lëjffa nuk duronte njeri t'ia ngacmonte dhe në rastet kur ndokush guxonte at'here hakmarrja e Ramizit ishte shembullore. Këto veprimet krijuan edhe opinionin që Ramizi është mendje ndarë e prandaj ia kishin frikën. Në gjirin familjar egzistonin të tilla mardhënie harmanoie e dashurie saqë Rifati, sa herë që përmendej emri i Ramizit, gjithmonë thoshte:“M'i thau krahët Ramizi “ – dhe sytë i mbusheshin me lot. Nuk e dijmë të vërtetën se përse Ramizi u stabilizua në punë shteti por është fakt që Ai ka qenë në punë në të njëjtën periudhë kur punonte edhe Isaja si Kryetar i Komunës Qendër Zerqan. Në të dhënat për Punonjësit e Drejtorisë së Financave për vitet 1925 – 1936 rezultoi edhe emri i Ramiz Hysenit (nga Fatos Daci në Enciklopedia e Dibrës 3 f. 30 & 40).

Ndonëse në mungesë të të dhënave arshivore , nga tregimet gojore të të bijës, Faries, e cila ndonëse në moshën 80 vjeç gëzon shëndet të mirë mendor, rezultojnë të dhëna me vlerë për Ramiz Hysenin në lidhje me përkushtimin ndaj bashkëshortes, në respektin ndaj atyre që e rritën dhe në shpirtin e tij patriotik dhe atdhetar.

Ramiz Hyseni rreth vitit 1934 u martua me Fitie Merdan Mehmetin nga Sopoti. Me Fitien lindën dy djem, nga të cilët jetoi vetëm Mehmeti, dhe një vajzë Fariën. Mehmetin e la 4 vjeç. Një koinçi-

dencë e çuditshëshme e fatit: 4 vjeç ngeli vetë jetim dhe po 4 vjeç la djalin jetim!... ! . Në vitin 1937, me ndihmën edhe të mixhës së vet i cili kishte njohje të shumta, emërohet xhandar në Librazhd. Aty “u tregua i aftë në ruajtjen e qetësisë, të ndjekjes së keqbërësve si në qytet ashtu edhe nëpër fshatra”. Në vitin 1938 transferohet në rrethin e Pogradecit në Post Komandën e qendrës së atij Qyteti. Edhe në Pogradec vazhdoi të punojë me atë takt e vrull pune, si në Librazhd, e për këtë fitoi respekt si nga eprorët e njëkohësisht edhe nga populli. Për këtë arësye u caktua si Zv/ Komandant i Postës së Xhandarmërisë së Qytetit . Prilli i vitit 1939 e gjeti në Pogradec. Aty edhe u lidh me Celulën e Partisë dhe e ndihmonte me informacione të ndryshme. Kjo periudhë pune e Ramizit pasqyrohet si vijon: - “Okupacioni fashist i 7 prillit 1939 e gjeti në armën e xhandarmërisë në Pogradec. Ai që në fillim ra në kontakt me shokët e rezistencës antifashiste dhe u solidarizua për të marrë pjesë në luftë kundër pushtuesve nazifashistë” (nga Xheladin Krifca në “Dibra dhe Dibra e Madhe në luftë “ f. 64). Aktiviteti i tij ra në sy të autoriteteve të cilët e trajtonin me motivacionin “Nën vërejtje”! Ndonëse nën masa të rrepta survejimi e mbikqyrjeje Ramizi nuk hoqi dorë nga rruga e filluar dhe jo vetëm që ishte i aktivizuar në përkrahje të lëvizjes antifashiste nacionalçlirimtare por edhe ishte i angazhuar në detyrimet ndaj familjes në Sopot. Në një moment deshiti që ta marrë bashkëshorten me të dy fëmijët në Pogradec që të realizonte një jetë normale familjare dhe këtë dëshirë ua çfajti edhe mixhallarëve por Isa Hyseni (Demiri) nuk e aprovoi! Jo pse nuk deshti me i pa bashkë si çift por ngaqë e dinte se Ramizi ishte futur në një rrugë të rrezikëshme për atë kohë, punonte për Lëvizjen Nacionalçlirimtare, dhe në rast të ndonjë rreziku mund t'i ngelnin fëmijët e Ramizit rrugave. Ramizi në respekt të atyre që e rritën por edhe i bindur në argumentimin logjik të fjalëve të Isasë nuk e mori të shoqen me gjithë fëmijë në Pogradec por e la në Sopot. Dhe mirë e bëri sepse autoritetet me të njëjtin motivacion e transferojnë për në Vlorë ku ... dhe aty u lidh menjëherë me grupin partizan të Vlorës ku jepte vazhdimisht informacione... Ai e urrente fashizmin me gjithë shpirt dhe tërë veprimtarinë e tij nën armën e fashizmit ai e ndërtoi në mënyrë të tillë që fashizmi të dështonte në Shqipëri dhe këtë kontribut Ramizi e dha duke bashkëpunuar me Lëvizjen Nacionalçlirimtare nën hundën e fashizmit.

Puna e tij në xhandarmëri ra shumë në sy. Para se ta zbulojnë dhe ta arrestojnë italianët ai doli në ilegalitet dhe u radhi në radhët e batalionit partizan të Dibrës (nga Xheladin Krifca në “Dibra dhe Dibra e Madhe në luftë” f.64). Dalja e tij në ilegalitet u realizua në mënyrë të përsosur sepse përveç Ramiz Hysenit, simpatizantë dhe përkrahës të Lëvizjes Antifashiste Nacionalçlirimtare, kishte edhe persona të tjerë që punonin në struktura të ndryshme të pushtetit të asaj kohe. Ata vunë në dijeni strukturat eprorë të Lëvizjes për rrezikun që i kanosej Ramizit dhe u vunë në veprim që ta shpëtonin patjetër shokun e tyre. Vunë në dijeni Haxhi Lleshin në Dibër i cili formulon një telegram dërguar Ramiz Hysenit: “Ke familjen në gjendje të rëndë shëndetësore. Merr leje dhe hajde shifi”! Ky telegram dha efektin e duhur. Ramiz Hyseni u largua nga Vlorë e nuk shkoi më. Përfundimisht u rrjeshtua në radhët partizane. U aktivizua si të gjithë shokët e tjerë në luftime të ndryshme dhe me fillimin e Opera-

cionit armik të Dimrit 1943 – 1944 u rrjeshtua në një grup me Haxhi Lleshin për të kaluar drejt Shqipërisë së Jugut. Gjatë lëvizjes u ndodhën në fshatin Llokëm të Maqedonisë. Këtë moment po e riprodhojmë si vijon: “Në katundin Llokëm, ashtu si në shumë katunde të tjera në këtë zonë, lëviznin forca gjermane dhe bashibozukët e Xhem Gostivarit në ndjekje të partizanëve. Edhe këtu kishin gdhirë një sasi e madhe e forcave gjermane të armatosura deri në dhëmbë, vendosur në fshat por pa roje në kodra ose në vende të përshtatshme për mbrojtjen e tyre .

Më datën 3 dhjetor 1943 kolona partizane me komandantin Haxhi Lleshi në krye hyri në fshat. Furtuna vazhonte. Brenda në fshat në befasi forcat partizane u përpoqën me ato gjermane. Lufta filloi e ashpër. Partizanët hapën zjarr të parët kundër nazistëve, në afërsi 3 – 4 metra. Pushkët e mitralozat nga të dy anët villnin zjarr, bombat e dorës shtonin më shumë ushtimën e pandërprerë të luftës së porsafilluar. Një pjesë e partizanëve menjëherë zuri pozicione në kodrat e fshatit, pjesa tjetër luftonte në fshat brenda. Kisha dhe varrezat e fshatit ishin në duart e partizanëve, ndërsa gjermanët ishin mbyllur të gjithë nëpër shtëpitë e fshatit. Disa prej tyre kishin zënë pozicione rreth e rrotull shtëpive. Nga ana e partizanëve u vunë në përdorim mitralozat e rëndë dhe mortajat. Gjermanët u tronditën, ata nuk e prisnin në orë e para të mëngjezit një luftë kaq të rrafshme nga ana e partizanëve, por edhe partizanët nga ana tjetër nuk e dinin se në këtë katund do të takoheshin me forca gjermane dhe do të përlesheshin me këta grykë më grykë. Pra të dy palët u gjendën në befasi. Pasi lufta zgjati më se dy orë, në ndihmë të forcave gjermane u nisën nga katundi Selcë forca të tjera gjermane. Armikut ndihma i erdhi shumë shpejt. Atëherë komanda partizane organizoi tërheqjen e forcave. Lufta qe e shpejtë, e rrufeshme. Armiku la në këtë betejë rreth 25 të vrarë e të plagosur. Nga forcat partizane mbetën të vrarë Ramiz Hyseni nga Sopoti i Zerqanit, Arif Losha nga Vlashaj i Shupenzës dhe një shoqe malazeze me emrin Donica Harito. U plagosën partizanët Nexhat Agolli, Leonidha Heba, Musa Lala, partizani jugosllav Radmillo Stanojeviç. Të vrarët e palës partizane nuk qe e mundur të tërhiqeshin, ndërsa të plagosurit u tërhoqën (në LUFTA ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE e popullit dibran, grup autorësh: Emin Agolli, Sali Hoxha, Xheladin Krifca, Pali Carapuli, Sefer Kosova, f.180 – 181). Këtë postim po e mbylлим me një shkrim sensibilizues të Kadri Dishës në gazetën “Telegraf 14 janar 2013” nga ku citojmë :

“Hiqen nga shkollat emrat e dëshmorëve të atdheu”. Në këtë artikull ndërmjet të tjerave lexojmë: “Shkolla 9-vjeçare dhe e mesme Zerqan mbante emrin e dëshmorit të atdheut të Luftës Nacional Çlirimtare Ramiz Hyseni. Kjo heqje e emrave është e qëllimshme, për të humbur meritat dhe sakrificat e partizanëve, baballarëve dhe gjyshërve tanë që sakrifkuan dhe jetën e tyre për çlirimin e plotë të vendit nga okupatorët fashisto-nazistë. E gjithë kjo luftë u bë që ne, brezat pasardhës të jetonim të lirë e ta pavarur nga askush në vendin tonë që quhet Shqipëri”.

Aktit heroik të Ramiz Hysenit i është kushtuar kënga me tekst të Dalip Skurës dhe me muzikë të Latif Okshtunit (ish mësues të shkollës 8 vjeçare “Jashar Kola “ Sopot. Kjo këngë është realizuar dhe ekspozuar në vitin shkollor 1972 – 1973.

Poemë e dhimbjes, kënduar vajshëm

POEZI NGA DHURATA KOLA KALOSHI

ATDHEUT

Dashuria ime për ty, lule petalekëputur.
Dashuria ime për ty, pëllumb krah'thyer.
Dashuria ime për ty, dallgë në shkemb per-
plasur.
Dashuria ime për ty, si zogu pa krye.

Dashuria ime për ty, ëndërr e vrarë.
Dashuria ime për ty, plag që pikon gjak.
Dashuria ime për ty, këngë pa refren.
Dashuria ime për ty, krismë që merr hak.



QYETI IM,

Qyteti im,
ti pejsazh i zymtë mbi sfondin gri,
ku natyra peneloi ashpër,
duke hedhur ngjyra të errëta pa kursim.

Qyeti im,
Ti poemë e dhimbjes, kënduar vajshëm,
plagë që dhemb, dashuri e brishtë.
Qyteti im,
Rrethuar nga male me barkun bosh.
Në labirinthe e galerive bëjnë garë jeta
dhe vdekja.

Në errësirën e tyre, jep shpirt buzëqeshja.
Qyteti im,
me burra shpinëkërrusur,
me fytyra të ashpra e me shpirt të butë,
me gra shamizeza e fëmijë jetim,
nga zgavrat e syve të tyre uria merr frymë.
Qyteti im,
Ti më i pasuri ndër të pasurit,
ti më i varfëri ndër të varfërit,
me shumë beteja por pa histori,
me shumë heronj, të pa lavdi.
Qyteti im,
Njerëzit nxitojnë të ikin prej teje,
të tjerë nxitojnë të vijnë.
Ti jeta e tyre,
ti vdekja e tyre,
ti shpresa e tyre,
Ti ..

26 nentor 2019

Toka u drodh.
Dita u terr.
U trazuen detet.
Njerzia u shkreh.
Qyteti ra.
Koha mbet,
bota ndali frymën.

Nga nënrrenojat klithma jetësh
shkulin malet,
çajn qiejt,
përplasnin meteorët,
shuajn diejt,
gjunjin zotat ..

Toka vazhdon të dridhet ...
Rrëzohen, shkërmoqen fasadat.
çirren, bien maskat ..

Zerqan, vijon të ruhet tradita e bluarjes së drithërave me anë të mullirit me ujë

Ndonëse në ditët e sotme produktet e dala nga drithërat e ndryshëm, shumë banorë i marrin të gatshme, ka ende zona që vijojnë të ruajnë traditën e prodhimit vetë të tyre. I tillë është edhe rasti i fshatit Valikardhe, në Njësinë Administrative Zerqan në Bashkinë e Bulqizës. banorë të këtij fshati, por jo vetëm, vijojnë të përdorin mullirin me ujë për bluarjen e drithërave. Por ekzistenca e këtij mulliri, është meritë e familjes Hidri e cila e mirëmban atë prej më shumë se tre brezash. Ismet Hidri thotë se kjo traditë e familjes së tij ruhet që prej tre brezash ndërsa kontributin më të madh e ka dhënë babai i tij. Por edhe Ismeti vetë ka



sakrifikuat duke lënë një punë që paguhej më shumë, për të vijuar traditën e mullixhiut. Nga ana tjetër, Ismeti thotë se dëshiron ta trashëgojë këtë traditë edhe tek fëmijët e tij.

Ai shprehet se sot janë mbi 10 fshatra që e përdorin këtë mulli, ndaj dhe tradita duhet të vazhdojë. Për banorët e zonës, përodinimi i mullirit me ujë për bluarjen e drithërave jo vetëm që ka kosto të ulët, por edhe nxjerr miell të pastër.

Ndonëse para disa dekadash mulliri me ujë ishte e vetmja mënyrë për të bluar drithërat, sot numri i tyre opo vjen duke u reduktuar ndjeshëm, duke shkuar drejt asaj që këto objekte të kthehen në vepra rralla.

Ai humbi jeten si pasoje e plageve te marra gjate shperthimit te nje mine te paplasur gjate misionit ne Letoni.



Major Klodian Tanushi i jepet titulli “Nderi i Qarkut Diber” pas vdekjes

Major Klodian Tanushi, i plagosur më 6 maj, 2019 gjatë kryerjes së detyrave luftarake, në misionin e NATO në Letoni i cili ndërroi jetë katër ditë pas ngjarjes, është vlerësuar nga Këshilli i Qarkut Diber me titullin “Nderi i Qarkut Diber”, pas vdekjes. Në këtë ceremoni morën pjesë autoritetet vendore të qarkut Diber, familjarë dhe të afërm të dëshmorit të Atdheut Klodian Nikolla Tanushi. Titullin “Nderi i Qarkut Diber” në emër të këtij këshilli ja dorezoi babait të majorit, kryetarja e keshillit të qarkut Diber Valentina Haliti. Babai i Majorit duke marrë këtë titull të lartë që i dha Këshilli i Qarkut Diber i falenderoi ato për këtë akt. Edhe deputetja e Qarkut Diber Almira Xhembulla, në fjalën e saj tha se ndjehej mirë që në këtë fund viti ne mblidheshin për t’i dhënë titullin “Nderi i Qarkut Diber” Major Klodian Tanushit.

Major Klodian Nikolla TANUSHI që humbi jetën në Letoni ka lindur në Diber më 31.10.1980. Ai është i martuar dhe ka tre fëmijë (dy djem dhe një vajzë) përkatësisht 14 vjeç, 11 vjeç dhe 1 vjeç e gjysmë.

Tanushi në vitin 1999 ka përfunduar shkollën e mesme profesionale “Nazmi Rushiti” në profilin “Motorist xhenerik”. Nga viti 2000 deri në vitin 2003 ka ndjekur studimet në Akademinë Ushtarake Skënderbej.

Ka kryer kurse funksional EOD Niveli I-re “Për asgjësimin e municioneve me eksploziv”.

Ka marrë pjesë në kursin “EUFOR Mine Awareness Instructor Course”.

Pas përfundimit të Akademisë është titulluar oficer dhe me urdhër nr.9628 datë 18.09.2003 ka marrë gradën e “Nëntogerit”. Në vitin 2006 ka marrë gradën e “Togerit”, në vitin 2010 ka marrë gradën e “Kapitenit” dhe në vitin 2017 ka marrë gradën e “Majorit”. Gjatë karrierës së tij ushtarake ka kryer detyra si : Komandant Toge, Komandant Kompanie, Shef Seksioni, Specialist Operacionesh. Aktualisht me detyrë Komandant i Togës së pare të EOD.

Në 20.12.2018 është dërguar me mision në Operacionin Ushtarak të NATO-s në Riga, Letoni në përbërje të Grup-batalionit kanadez me detyrë Komandant i Kontigjentit shqiptar dhe përfaqësues i lartë ushtarak, me afat qëndrimi 6-mujor.

Gjatë karrierës së tij është vlerësuar me Medaljen e “Karrierës” nga Komandanti i Forces, Medaljen e “Shërbimit” nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, Medalje shërbimi në Mision jashtë vendi si dhe Medaljen “Për pjesëmarrje në shërbime ndërkombëtare” nga Ministri i Mbrojtjes.

Ai humbi jeten si pasoje e plageve te marra gjate shperthimit te nje mine te paplasur gjate misionit ne Letoni. Si pasoje e shperthimit fillimisht humbi jeten nentetarja Zarife Hasanaj e me pas pak dite më vonë major Tanushi. Major Tanushi la pas bashkëshorten dhe tre fëmijë, dy djem dhe një vajzë.



RETE PAS

Shërbime shëndetësore me cilësi të lartë dhe çmime të përballueshme

Një program i rezervuar dhe personalizuar për qytetarët shqiptarë për të hyrë në shërbime shëndetësore me cilësi të lartë dhe çmime të përballueshme.



FIRENZE RETE PAS, GARANTON: Shërbime shëndetësore në të gjitha disiplinat e specializuara diagnostikuese dhe rehabilituese; Një rrjet ambulatori iali përbërë nga 11 qendra në territorin e Firences dhe me një mesatare prej 20,000 hyrje në muaj.

Shërbim i shpejtë pa kohëpritje.

Komunikimi mundsohet nga përkthyes të specializuar në këtë fushë

NDËR SPECIALITETET QË NE OFROJMË JANË

- Alergologjia, Angiologji, Kardiologji, Kirurgji, Dietologji, Dermatologji, Ecografi, Endokrinologji, Gastroenterologji, Gjinekologji, Gjeriatri, Neurologji, Nefrologji, Okulistika, Ortopedia, Osteopatia, Otorinolaringologji, Pediatria, Pneumologji, Psikiatri

RETE PAS ofron shërbime shëndetësore me tarifa të përballueshme për të gjithë, me një ekip mjekësh italianë me aftësi të larta, veçanërisht në fushën e diagnostikimit:

- radiologji,
- resonance magnetike, tac – Mamografi dhe tomosintezë, - ekografi ... me përdorimin e pajisjeve të avancuar për rindërtimin e imazheve volumetrike, në tredimensione (siç është për tomosintezën e gjirit).

ORGANIZOJME GJITHÇKA në kohën që ju ose i afërm juaj do asistohen/ni në strukturat tona. • Shoqërimi në çdo vizitë e pacientit me përkthyes shqiptar.

Per informacione dhe prenotime na \kontaktoni: Email: age.biba@gmail.com
Tel 00392380019580
WhatsApp 00392380019580
Age Biba (Dukagjini)

Organizojmë gjithçka në kohën që ju ose i afërm juaj do asistohen/ni në strukturat tona. • Shoqërimi në çdo vizitë e pacientit me përkthyes shqiptar.

Për informacione dhe prenotime na kontaktoni: Email age.biba@gmail.com
Tel 00392380019580 WhatsApp 00392380019580
Age Biba (Dukagjini)